



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Cp.nr.101/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË LIPJAN**, Departamenti i Përgjithshëm – **Divizioni Civil**, gjyqtari përmbarimor Isa Gashi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorve L. Ll. nga fsh. ..., N. T. nga fsh. ..., Sh. S.-M. nga ... dhe Z. M. H. nga ..., të cilët i përfaqëson me autorizim, Q. R. av. nga ..., kundër debitorit Komuna e Lipjanit-Drejtorati per Arsim me seli ne Lipjan, për përmbarimin e kërkesës në të holla, me datën 18.07.2023, lëshon këtë:

### **URDHËRESË**

**URDHËROHET** departamenti i thesarit i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, që menjëherë ta përmbaron aktvendimin për përmbarim të kësaj gjykate Cp.nr.101/2023 te dt.07.06.2023, i lejuar në bazë të dokumentit përmbarues - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - dega në Lipjan C.nr.195/2020 të dt. 06.09.2021, i plotfuqishëm që nga dt.31.08.2022 dhe i ekzekutueshëm që nga dt.02.11.2022, dhe ti bartë mjetet në të holla, për të cilat është caktuar përmbarimi, nga llogaria e debitorit Komuna e Lipjanit, me seli në Lipjan - Drejtorati Komunal i Arsimit, përkatësisht nga thesari, në llogari të të autorizuarit të kreditorit - av. Q. R. nga ..., në llogarinë bankare nr.... ne BPB ne Prishtine dhe ate:

1-Per kreditorin L. Ll. nga fsh. ... në shumë prej 1.756.90€ ne emer te kamates te arritshme shumen prej 448.80€, shumen prej 325.95-€ ne emer te kamates se llogaritur nga dt.06.09.2021 e deri me dt.10.07.2023,në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumen prej 3.498.20€ ,në emër të shpenzimeve të procedurës përmbarimore shumen prej 1.190,00€ (shumën prej 390.00-€ për hartim të propozimit për përmbarim,shumen prej 390,00€ per pergjigje ne prapesim ,shumen prej 250.00€ per ekspertize financiare per llogaritjen e kamates dhe shumën prej 160.00-€ në emër të taksës gjyqësore për lejim të propozimit)

Ne emer te kreditores ne trustin pensional shumen prej 22.96 euro,ne emer te tatimit ne te ardhura ne Administraten tatimore te Kosoves shumen prej 5.52 €.

2-Per kreditoren N. T. nga fsh. ..., në shumë prej 4.003.23€, shumen prej 994.38€ ne emer te kamates se arritshme , shumen prej 591.59-€ emer te kamates nga dt.06.09.2021 e deri me dt.10.07.2023.

Ne emer te kreditores ne trustin pensional shumen prej 254.20 euro,ne emer te tatimit ne te ardhura ne Administraten tatimore te Kosoves shumen prej 221.27 €.

3-Per kreditoren Sh. S.-M. nga ... , në shumë prej 4.128.25€, shumen prej 1.019.87€ ne emer te kamates se arritshme , shumen prej 610.06-€ emer te kamates nga dt.06.09.2021 e deri me dt.10.07.2023.

Ne emer te kreditores ne trustin pensional shumen prej 242.00 euro,ne emer te tatimit ne te ardhura ne Administraten tatimore te Kosoves shumen prej 213.83 €.

4-Per kreditoren dhe Z. M. H. nga ... , në shumë prej 3.879.95€, shumen prej 952.95€ ne emer te kamates se arritshme , shumen prej 573.37-€ emer te kamates nga dt.06.09.2021 e deri me dt.10.07.2023.

Ne emer te kreditores ne trustin pensional shumen prej 242.74 euro,ne emer te tatimit ne te ardhura ne Administraten tatimore te Kosoves shumen prej 213.88 €.

OBLIGOHET departamenti i thesarit i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, të Qeverisë së Republikës së Kosovës që përkitazi me përmbarrimin e këtij aktvendimi ose për pengesat eventuale për përmbarrim ta njoftoj gjykatën me shkrim.

Bashkë me këtë urdhëresë u'a dërgojmë:

- Aktvendimin për përmbarrim Cp.nr.101/2023 dt.07.06.2023,
- Aktvendim CP.nr.101/2023 i dt.30.06.2023.
- Akgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë –Dega në Lipjan C.nr.195/2020 dt.06.09.2021 i plotfuqishëm që nga dt.31.08.2022 dhe i ekzekutueshëm që nga dt.02.11.2022.

**G J Y Q T A R I**

**Isa Gashi**